



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.549/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rinor Gashit, nga fshati Sllovi Komuna e Lipjanit, paraqitur për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Rinor Gashit, nga fshati Sllovi Komuna e Lipjanit, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 30.10.2014, nga Rinor Gashi, nga fshati Sllovi Komuna e Lipjanit, kryesues në Qendrën e Votimit 1317e/03R, me të cilën e ka njoftuar PZAP se gabimisht ka plotësuar Formularin e Rezultatëve për kandidat në vendvotimin nr. 1317e/03R, duke theksuar se pasi që janë publikuar në web-faqe nga ana e KQZ-së të Formularëve të Përputhjes së Rezultatëve, ka vërejtur se në vendvotimin 1317e/03R në fshatin Sllovi Komuna e Lipjanit, ka harruar të përshkruaj në mënyrë të sakt votat për kandidatët për Kuvend Komunal dhe se kjo ka ndodhur si pasojë e lodhjes së madhe të të gjithë anëtarëve të KVV-së, pasi që për herë të parë ka qenë i angazhuar si kryesues dhe se asnjë anëtarë tjetër i KVV-së nuk e ka vërejtur gabimin në FRK. Me këtë rast ka kërkuar që të rinumërohet kutia e votimit për Kuvend Komunal në vendvotimin 1317e/03R.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankeses gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsit në vendvotimin 1317e/03R në fshatin Sllovi, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Rinor Gashi, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZLAnr.549/2017 më datën 31.10.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.